



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 825 , datë 7.10.2015

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE PËR DHËNIEN  
E LEJES PËR HAPJEN, MBYLLJEN DHE FUNKSIONIMIN  
E INSTITUCIONEVE PRIVATE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR,  
NË TË CILAT ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE  
APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4, 5 e 6, të nenit 42, të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim përcakton kriteret e procedurat për dhënien e lejes për hapjen, mbylljen dhe funksionimin e institucioneve arsimore private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj.
2. Institucione të arsimit parauniversitar privat, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, janë institucionet e mëposhtme, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:
  - a) kopsht (arsimi parashkollor);
  - b) shkollë e arsimit fillor;
  - c) shkollë e arsimit të mesëm, të ulët;
  - ç) shkollë e arsimit bazë;
  - d) shkollë e arsimit të mesëm, të lartë.

## II. HAPJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE, NË TË CILAT ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ

Kërkesa për hapjen e një institucioni arsimor privat të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj bazohet në kriteret e procedurat e mëposhtme dhe shoqërohet me këto dokumente e deklarata:

### 1. Për subjektin juridik përgjegjës:

- a) Regjistrimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si person juridik, me objekt veprimtarie në fushën e arsimit parauniversitar, ose në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- b) Numri i identifikimit i personit të tatueshëm (NIPT) dhe ekstrakti historik i subjektit.
- c) Kopje të dokumenteve të pronësisë apo të qerasë për objektin dhe mjediset e tjera ndihmëse, në të cilat do të zhvillohet veprimtaria, të noterizuara dhe të nxjerra jo më herët se tre muaj nga data e depozitimit të kërkesës.
- ç) Vërtetimi se subjekti juridik nuk është në ndjekje penale nga organi i prokurorisë, nuk është në proces gjyqësor ose i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për vepra penale që lidhen me veprimtarinë profesionale, lëshuar nga organet kompetente.
- d) Deklarata që subjekti juridik ka të ardhura financiare të mjaftueshme për të ushtruar veprimtarinë për të cilën kërkohet marrja e lejes dhe të dhënat për burimet e të ardhurave; një plan/raport i detajuar për kryerjen e veprimtarisë mësimore si dhe tarifatat e parashikuara për nxënësit/të tretë për shërbimin e mësimdhënies.
- dh) Kërkesa, nga subjekti juridik, drejtuar bashkësisë përkatëse fetare, për hapjen e një institucioni arsimor privat, ku do të zhvillohen edhe lëndë fetare.
- e) Dokumenti që vërteton pagesën e tarifës së shërbimit, sipas pikës 1, të kreut IV, të këtij vendimi.

### 2. Për institucionin arsimor privat:

#### a) Të dhëna për institucionin:

- emërtimi i institucionit arsimor privat;
- emërtimi i njësisë arsimore vendore, që do ta ketë në juridiksion institucionin arsimor privat;
- Vendndodhjen e institucionit;
- Adresën postare dhe adresën elektronike të institucionit.

- b) Lloji i institucionit arsimor, sipas shkronjës “ç”, të kreut I;
- c) Deklarata, në të cilën subjekti juridik merr përsipër respektimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e institucioneve arsimore, në përgjithësi, dhe atyre private, në veçanti;
- ç) Deklarata për llojet e programeve arsimore që institucioni do të ofrojë për nxënësit;
- d) Deklarata për tarifatat dhe modalitetet e pagesave që do të kontrahohen me përfituesit e shërbimit;
- dh) Deklarata për grupet/klasat që do të hapen në fillim e në pesë vitet në vazhdim dhe parashikimi i përafërt për numrin e nxënësve për klasë;
- e) Kriteret dhe procedurat e vendosura nga institucioni arsimor privat për pranimin e nxënësve;
- ë) Deklarata që tregon se cilat janë organet që drejtojnë institucionin arsimor;
- f) Miratimi, me shkrim, i njësisë përkatëse arsimore vendore për rregulloren e brendshme të institucionit arsimor privat, së bashku me këtë rregullore.

### 3. Për mjediset e institucionit arsimor privat:

- a) Dokumentacioni për plotësimin e kriterëve higjieno-sanitare dhe të mbrojtjes kundër zjarrit, të lëshuara nga organet kompetente, jo më herët se tre muaj që nga data e depozitimit të kërkesës.
- b) Deklarata për krijimin e kushteve për nxënësit me aftësi të kufizuara në mjediset shkollore.
- c) Dokumenti i verifikimit, nga njësi arsimore vendore përkatëse, për përmbushjen e standardeve të infrastrukturës, të paraqitura në shtojcën bashkëngjitur këtij vendimi.

### 4. Për dokumentacionin kurrikular:

- a) Deklarata për strukturën e vitit shkollos, planin mësimor dhe programet mësimore që do të zhvillojë institucioni arsimor privat. Kur, për një lëndë, programi mësimor është i njëjtë me atë të institucioneve analoge arsimore publike, është e mjaftueshme deklarata që e pohon këtë fakt. Programet mësimore në gjuhë të huaj paraqiten në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Për nxënësit me shtetësi shqiptare, lëndët “Gjuha Shqipe”, “Letërsia”, “Historia e Kombit Shqiptar” dhe “Gjeografia e Shqipërisë” paraqiten për miratim dhe zhvillohen në gjuhën shqipe;
- b) Lista e teksteve për nxënësit, që do të përdoren nga institucioni arsimor privat, shoqëruar me fotokopjet e kopertinave të secilit tekst, të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Kur, për një lëndë, teksti është i njëjtë me atë të institucioneve analoge arsimore publike, është e mjaftueshme deklarata që e pohon këtë fakt. Tekste të caktuara vihen në dispozicion të

Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, kur kërkohet prej saj, të përkthyer në gjuhën shqipe;

- c) Lista e plotë e pajisjeve dhe mjeteve mësimore si dhe inventari i mjeteve kryesore të laboratorëve mësimorë, që deklarohet të jenë në shërbim të realizimit të kërkesave të programeve mësimore;
- ç) Modeli i dokumentit që institucioni arsimor lëshon në përfundim të çdo viti mësimor dhe nivelit të arsimit, në gjuhën në të cilën zhvillohet dhe në gjuhën shqipe.

#### 5. Për punonjësit arsimorë:

- a) Lista e plotë e personelit drejtues, mësimdhënës e ndihmës, shoqëruar me kopjet e noterizuara të diplomave të shkollës së lartë. Për shtetasit e huaj, ato duhet të jenë të përkthyer dhe të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- b) Deklarata e drejtuesve të institucionit arsimor privat që do të punojnë me kohë të plotë në institucion;
- c) Lejet e qëndrimit dhe lejet e punësimit për shtetasit e huaj që shërbejnë në institucionin arsimor privat.

Për çdo nivel arsimor: arsim parashkollor, arsim bazë dhe arsim i mesëm, i lartë si dhe për dy rastet e institucioneve arsimore private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, paraqiten kërkesë dhe dokumentacion i veçantë për leje.

### III. PROCEDURAT E DHËNIES SË LEJES

1. Subjekti paraqet kërkesën, për hapjen e një institucioni arsimor privat të arsimit parauniversitar, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, jo më vonë se 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor.
2. Kërkesa e subjektit, së bashku me dokumentacionin e kërkuar, depozitohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila, brenda 30 ditëve, kryen vlerësimin juridik e teknik të dokumentacionit të paraqitur dhe i paraqet subjektit vlerësimin me shkrim. Ky dokument bëhet pjesë e dosjes.
3. Kur dokumentacioni i paraqitur ka mangësi, subjekti ka 20 ditë afat t'i plotësojë ato.

Paraqitja e dokumentacionit të plotësuar trajtohet brenda 30 ditëve, nga data e paraqitjes së tij.

Nëse kërkesa refuzohet, subjekti nuk mund të aplikojë përsëri, për atë vit shkollor, për hapjen e një institucioni arsimor privat të arsimit parauniversitar, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj.

Në të gjitha rastet, paraqitja e propozimit për miratim nga Këshilli i Ministrave, për hapjen e institucionit arsimor privat të arsimit parauniversitar, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, duhet të jetë përpara datës së fillimit të vitit mësimor.

4. Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të subjektit, Ministria e Arsimit dhe Sportit kërkon raporte ekspertize, përkatësisht nga:
  - a) institucionet vartëse të specializuara për vlerësimin e kurrikulave;
  - b) përfaqësuesit e bashkësisë fetare dhe Komiteti Shtetëror për Kultet, kur institucioni arsimor privat do të zhvillojë edhe lëndë fetare.
5. Ministri i Arsimit dhe Sportit i propozon Këshillit të Ministrave projektvendimin për hapjen e institucionit arsimor privat përkatës, pasi të jenë përmbushur kriteret, sipas këtij vendimi.

#### IV. TARIFAT E SHËRBIMIT

1. Tarifat e kërkesave për hapje të institucioneve arsimore parauniversitare private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, janë sipas tabelës në vazhdim:

Nr.	Institucionet	Tarifa në lekë
1.	Për kopsht	35 000 (tridhjetë e pesë mijë)
2.	Për shkollë të arsimit fillor	45 000 (dyzet e pesë mijë)
3.	Shkollë të arsimit të mesëm, të ulët	45 000 (dyzet e pesë mijë)
4.	Shkollë të arsimit bazë	55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë)
5.	Shkollë të arsimit të mesëm, të lartë	70 000 (shtatëdhjetë mijë)

2. Tarifa e shërbimit paguhet për llogari të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Shuma e të ardhurave të realizuara nga tarifat e shërbimit, sipas pikës IV, të këtij vendimi, derdhet 100% në buxhetin e shtetit.
3. Tarifat e paguara për shërbimet, sa më lart, janë të pakthyeshme.

## V. MBYLLJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, NË TË CILAT ZHVILLOHEN EDHE LËNDË FETARE APO KU MËSIMI ZHVILLOHET EDHE NË GJUHË TË HUAJ

1. Subjekti, që e mbyll vetë institucionin arsimor privat, njofton me shkresë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për arsyet e mbylljes. Kur një subjekt nuk e përmbush këtë detyrim, ai nuk ka të drejtë të kërkojë hapjen e një institucioni arsimor privat, të çfarëdo lloji, për 5 vite shkollore pasuese.
2. Subjekti që nuk e hap institucionin arsimor privat gjatë dy viteve shkollore të njëpasnjëshme, nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, e humbet të drejtën e hapjes së institucionit. Subjekti duhet të përsëritë procedurat për rihapjen e institucionit arsimor privat.
3. Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe autoritetet tatimore njoftojnë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kur konstatojnë shkelje të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim nga institucionet arsimore private.

Ministri i Arsimit dhe Sportit, pas njoftimit nga këto organe publike,:

- a) njofton subjektin që të kryejë përmirësimet në dokumentacion ose ndreqjet në infrastrukturë, brenda një afati të caktuar;
  - b) paraqet propozimin në Këshillin e Ministrave për mbylljen e institucionit.
4. Subjekti, pas miratimit për hapjen e institucionit arsimor privat, ka detyrimin të njoftojë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me shkresë zyrtare, jo më vonë se tre muaj para fillimit të vitit shkollor, kur ndryshon:
    - a) vendndodhja e institucionit;
    - b) numri i klasave paralele (kur shtohet);
    - c) struktura e vitit shkollor, plani mësimor ose ndonjë program mësimor;
    - ç) aspekte të infrastrukturës, sipas shtojcës.
  5. Subjekti, për ndryshimin/ndryshimet e parashikuara në pikën 4, të këtij kreu, paraqet dokumentacionin, sipas këtij vendimi, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.  
Pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashikuar më sipër, ministri i Arsimit dhe Sportit:

- a) njofton subjektin që të kryejë përmirësimet në dokumentacion ose ndreqjet në infrastrukturë, sipas afateve të përcaktuara;
  - b) miraton ndryshimet e mësipërme;
  - c) paraqet propozimin në Këshillin e Ministrave për mbylljen e institucionit, në rast mosplotësimi të dokumentacionit ose të kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
6. Me mbylljen e institucionit arsimor privat, njësia arsimore vendore përkatëse tërheq të gjithë dokumentacionin arsimor të institucionit.

## VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr.248, datë 28.5.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare ose ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj”, shfuqizohet.
2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësitë bazë të qeverisjes vendore dhe njësitë arsimore vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I ARSIMIT  
DHE SPORTIT

LINDITA NIKOLLA

## SHTOJCË

### STANDARDET E INFRASTRUKTURËS SË OBJEKTIT SHKOLLOR

1. Klasa, si mjedis mësimor, të ketë një normativë sipërfaqeje shfrytëzimi prej 1.3-1.6 m<sup>2</sup>/nxënës.
2. Ndërtesa dhe mjediset e saj të plotësojnë kushtet për sigurimin e jetës dhe të shëndetit, të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.
3. Të sigurohen, sipas legjislacionit në fuqi, shërbimet e mëposhtme:
  - a) furnizimi me ujë;
  - b) ngrohja;
  - c) furnizimi me energji elektrike;
  - ç) komunikim telefonik dhe interneti.
4. Numri i nxënësve, në çdo dhomë mësimore, të jetë jo më i madh se standardet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
5. Nyjet hidrosanitare të përfshijnë 1(një) boks për 40 djem, 1 (një) boks për 30 vajza si dhe 1 (një) boks për punonjësit arsimorë të institucionit.
6. Për kopshtet, shërbimet higjienike të jenë të vendosura pranë çdo grupi të nxënësve. Numri i bokseve të jetë 3, për një grup. Bokset të jenë të ndara me mure nga njëri-tjetri dhe të kenë nga 4 lavamanë me ujë të pijshëm. Banjat të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja.
7. Për lëndën e edukimit fizik të jetë në dispozicion një palestër sportive. Për shkollat nën 100 nxënës mund të shfrytëzohet një klasë, në katin përdhe të godinës, me përmasa 60 m<sup>2</sup>, dhe një kënd sportiv jo më i vogël se 100 m<sup>2</sup>.
8. Objektet arsimore, që vihen në dispozicion për nivele të ndryshme shkollimi (kopshte, arsim bazë dhe arsim i mesëm i lartë), të jenë mjedise që nuk komunikojnë me njëri-tjetrin.
9. Sipërfaqja e dritareve të mbulojë, minimalisht, 15% të sipërfaqes së dyshemesë, dhe ndriçimi të jetë në krahun e majtë të nxënësit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi të realizohet me dritare me xham të tejdukshëm. Dritaret nuk lejohet të vendosen në murin ku është vendosur tabela e zezë.
10. Në shkolla të jenë, të paktën, aq dhoma mësimore sa është numri i klasave. Në shkollat e arsimit bazë dhe gjimnaze të jenë 1-2 dhoma për mësuesit.

Për kopshtet të jenë të paktën 3 dhoma mësimore dhe një dhomë mësuesish.

11. Objektet arsimore me mbi 200 nxënës të pajisen me dalje dhe shkallë emergjence.
12. Objektet arsimore të jenë të pajisura me kutinë e ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e nevojshme në të.
13. Objektet arsimore të kenë sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.
14. Objektet arsimore të jenë të ndërtuara me materiale që plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe nuk janë të rrezikshme për shëndetin e nxënësve dhe punonjësve arsimorë.  
Këto materiale të sigurojnë akustikë të mirë, në mjediset e mësimi, dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave të jashtme dhe luhatjeve të temperaturës.
15. Objektet arsimore të jenë larg zonave industriale, varrezave ose zonave me ndotje mbi normat e lejuara.

NR.PROT.3918/1  
DATE 8.10. 2015

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE DHE  
RINISË  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME  
PARLAMENTIN  
KOMITETIT SHTETËROR PËR KULTET  
DREJTORIVE RAJONALE ARSIMORE  
GJITHË BASHKIVE  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

